



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/02/25
Datë: 21.03.2025

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Shpejtim Gacaferi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e tretë (03) - e rregullt 2025 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 28.03.2025, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Arsycetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025;
4. Njoftim mbi shfrytëzimin e pronave komunale;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës të Planit Lokal për barazi gjinore 2025-2027 dhe Plan i Veprimit;
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
7. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/02/25
Datë: 21.03.2025

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: **Shpejtim Gacaferi** – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e tretë (03) - e rregullt 2025 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 28.03.2025, ora 10⁰⁰.

Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025;
4. Njoftim mbi shfrytëzimin e pronave komunale;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës të Planit Lokal për barazi gjinore 2025-2027 dhe Plani i Veprimit;
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
7. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

01/Mr. Prot. 2-155/1920
Njës. Drg. 2
Nr. i flet. 19/03/2025
Data 19/03/2025



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	
DATE:	19.03.2025
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës së Junikut
NGA/OD/FROM:	z.Zenun Shala – Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim mbi shfrytëzimin e pronave Komunale

Të nderuar,

Bazuar në përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr.03/L-040);me Ligjin Nr.06/L-092,neni 13 pika 1 dhe 2 , Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mjedis ka publiku me daten 30.12.2024 listen e pronave te cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim.

Edhe pse është shpallë lista e veçantë e pronave Komunale që do të ipen në shfrytëzim, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis nuk ka pranuar asnjë kërkesë për marrjen në shfrytëzim të këtyre pronave.

Bashkangjitur gjeni listen e veçantë të pronave Komunale që janë planifikuar te ipen në shfrytëzim

Me respekt!

Lista e veçantë e pronave Komunale që planifikohen të ipen në shfrytëzim

Nr.	Certifikata nr.	Ngastr a	Titullari	Sipërfaqja - m ²	Kulturë-Klasa	Vendi i quajtur
1	116	704	Komuna e Junikut	56579	Mal-4	Vrëshat- Rogopeq
2	//	793	//	17089	Kullosë-4	Bajraktar-Rogopeq
3	//	804	//	51249	Mal-4	Vrëshat -Rogopeq
	//	5032	//	13817	Mal -3	Qesta e Qokut
	//	5035	//	69770	Mal-2	//
4	//	1174	//	7633	Jo pjellore	Bajraktar-Varrezat e Imeraj
5	//	5183		1080	Tokë ndërtimore- Oborr	Hoxhë
6	//	3973	//	13072	Kullosë-3	Kloshe -Qesta e Gojanit
7	//	3975	//	1527	Mal-3	//
8	//	4042	//	1099	Livadh-3	Luga e Begut-Bramatok
9	//	4064	//	618	Kullosë-2	//
	115	1036-1	//	8616	Kullosë -3	Pepsh-Vrëshia e Pepshit
	//	1036-2	//	548	Rrugë	//



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA	
REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
DI/Nr. Prot.	9-155/1755
Një. Ore	2
Nr. i faq.	22
Data	14/03/2025



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

DATE/A:	14.03.2025
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal
CC:	z.Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	znj.Leonora Shehu Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dhe miratimin e Planit Lokal për barazi gjinore 2025-2027 dhe Planin e Veprimit

I nderuar,

Grupi punues i formuar për hartimin e Planit Lokal për barazi gjinore 2025-2027 dhe Planin e Veprimit, kërkon nga Kuvendi Komunal miratimin e këtij Plani.

Të bashkëngjitur në kërkesë keni Planin Lokal për barazi gjinore 2025-2027 dhe Planin e Veprimit.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNK – OPŠTINA JUNK – MUNICIPALITY JUNK



PLANI LOKAL PËR BARAZI GJINORE 2025-2027
DHE PLANI I VEPRIMIT

Shkurt 2025

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE	3
FJALA E KRYETARIT	4
I. HYRJE	5
II. METODOLOGJIA	8
III. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE	9
IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE	12
V. ANALIZA E PËRGJITHSHME GJINORE NË KOMUNËN E JUNITKUT	16

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

1. ABGJ- Agjencia për Barazi Gjinore
2. BDPfA -Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit
3. CEDAW -Konventa për Fliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave
4. EU GAP III- Plani i Veprimt për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
5. KBGJ- Komiteti për Barazinë Gjinore
6. OJQ- Organizatë Jo-Qeveritare
7. PLVBGJ- Plani Lokal i Veprimt për Barazinë Gjinore
8. PKBGJ- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
9. SDG- Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm
10. ZBGJ- Zyrtare/Zyrtar për Barazinë Gjinore

LISTA E TABELAVE

1. **Tabela 1.** Rezultatet e pritshme, objektivat specifik dhe treguesit
2. **Tabela 2.** Plani i Veprimt për Barazinë Gjinore 2025/2027
3. **Tabela 3.** Plani i monitorimit të zbatimit të Planit Komunal për Barazi Gjinore 2025/2027

FJALA E KRYETARIT

Kam nderin dhe kenaqesine t'ju prezantoj Planin Komunal per Barazi Gjimore 2025-2027, nje dokument te rendesishem per qytetarët e Komunës së Junikut, i cili ka si qellim te avancoj dhe forcoj barazine gjimore ne çdo aspekt te jetës shoqërore dhe ekonomike. Ky plan është hartuar per nje periudhe trevjeçare dhe percakton hapa te qarte dhe konkrete per te siguruar mundësi te barabarta per te dyja gjinitë ne te gjitha fushat e jetës.

Nje nga synimet kryesore te ketij plani është eliminimi i çdo forme te diskriminimit gjinor dhe krijimi i nje shoqërie ku gratë dhe burrat mund te perfitojne nga mundësitë e barabarta, duke siguruar kështu nje zhvillim demokratik te shëndetshem dhe te qëndrueshem. Ky plan është nje hap i rendesishem ne forcimin e mundësive per gratë dhe burrat ne Komunën e Junikut, si dhe nje angazhim per te përmirësuar gjendjen e barazisë gjimore.

Ne këtë dokument, janë identifikuar problematikat ekzistuese, janë përcaktuar prioritetet dhe janë planifikuar aktivitete dhe projekte qe do te realizohen ne periudhen e ardhshme. Ky plan është ne përputhje te plotë me instrumentet kryesore vendore dhe ndërkombetare per Barazi Gjimore, duke synuar përmbushjen e objektivave te këtyre dokumenteve strategjike ne nivelin komunal.

Per realizimin e ketij plani, do te angazhohen institucione te ndryshme, te cilat do te punojne ne koordinim te ngushtë per te siguruar zbatimin e tij me përpikëri dhe angazhim. Zyra per Barazi Gjimore, ne koordinim me autoritetet lokale, do te jetë përgjegjëse per implementimin e aktiviteteve dhe do te krijojë mundësi per mbështetje nga donatorët per realizimin e projekteve.

Si Kryetar i Komunës, angazhimi im per përmirësimin e jetës së qytetarëve do te jetë i palëkundur. Përkushtimi ynë është per te krijuar nje shoqëri ku barazia gjimore është nje vlerë e thellë dhe nje prioritet ne zhvillimin e shoqërisë. Ky plan është nje hap përpara per te siguruar qe gratë dhe burrat ne Komunën e Junikut te kenë mundësi te barabarta per te kontribuar dhe përfituar ne çdo fushë te jetës shoqërore dhe ekonomike.

I. HYRJE

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2025-2027 u përgatit nga Komuna e Junikut, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore të bazuara në:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejt për së drejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit.
- Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuara tek barazia, mosdiskriminimi dhe fuqizimi i grave.
- Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.
- Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuara tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integritit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në jetën lokale, etj.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011).¹

Siç përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në jetën lokale², njësitë e vetëqeverisjes lokale janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e akterëve

¹ Për një listë më të plotë me koncepte mund të vizitoni edhe: <https://eige.europa.eu/thesaurus/browse>

² Tekstin e Kartës mund ta gjeni në: <https://charter-equality.eu/the-charter/observatoire-europeen-cit.html>

lokal, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave³, të rejave dhe të rinjve⁴, vajzave dhe djemëve⁵.

Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes lokale. Barazia gjinore prej vitesh është evidentuar si një çështje me përparësi në nivel vendi e për këtë qëllim edhe në nivelin lokal është punuar e po punohet vazhdimisht. Në nivel vendi, në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024 i cili bazohet në Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, jepen qartësisht fushat kryesore të ndërhyrjes si dhe objektivat specifike për zbatimin e të cilave duhet të punojnë së bashku institucionet qendrore, lokale, OJQ-të dhe të gjithë partnerët lokal, kombëtarë e ndërkombëtarë.

Në zbatim të kornizës ligjore e të politikave në fuqi në lidhje me çështjet e barazisë gjinore, Komuna e Junikut, ka të cmëruar një Zyratë për Barazinë Gjinore e cili në mënyrë të përvitshme harton dhe zbaton një plan të veprimeve konkrete për përparimin drejt barazisë gjinore. Ky plan e ka gjetur zbatimin me mbështetjen financiare nga komuna dhe donatorë. Po kështu, Komuna e Junikut po aplikon parimet e integrimit gjinor dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor përmes analizave gjinore të programeve të drejtorive të caktuara⁶, mbledhjes së të dhënave të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore, përcaktimit të treguesve të ndjeshëm gjinorë, etj.

Megjithatë, pavarësisht përparimit të bërë në këtë drejtim në nivel vendor apo komunal, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes lokale të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin ekonomik dhe shoqëror.

PLVBGJ 2025 - 2027 është konceptuar dhe lidhur pikërisht me kornizën ligjore dhe të politikave kombëtare, por mbështetet dhe merr frymëzim edhe nga dokumentet ndërkombëtarë të rëndësishëm për barazinë gjinore. Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë plan, janë hartuar duke pasur parasysh faktin që asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë

³ "Gra dhe burra" në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 15 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit)

⁴ "Të reja dhe të rinj" në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 18 - 35 vjeç

⁵ "Vajza dhe djem" në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 0 - 18 vjeç

⁶ Rol të rëndësishëm këtu ka luajtur edhe mbështetja e vazhdueshme e dhënë nga UN Women, sidomos në kuadër të Programit Rajonal: "Financimi transformues për Barazinë Gjinore drejt një Qeverisjeje më Transparente, Gjithëpërfshirëse dhe Llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor", i financuar nga SIDA dhe i zbatuar në Kosovë prej vitit 2020.

të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të reja e të rinjve, vajzave e djemëve pra të gjithë anëtarëve dhe anëtarëve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave dhe vajzave mbetet një ndër synimet kryesore për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore. Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithë përfshirjes në të gjithë tekstin në vijim në këtë PLVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja “në të gjithë diversitetin e tyre”.⁷ Përmes saj theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave dhe vajzave (por edhe burrave, dhe djemëve) në tërësi përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëlloshëm e të ndërthurur për shkak të seksit, moshës, zonës ku jetojnë, etnisë, aftësive të kufizuara, nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, të qenit prind i vetëm, të qenit viktimë / e mbijetuar / i mbijetuar i trafikimit të qenieve njerëzore apo formave të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, statusit të migrantes / migrantit, azilkërkueses /azilkërkuesit, etj.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PLVBGJ 2025 – 2027, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit përkatës dhe dokumentet kryesore ku mbështeten hapat e planifikuar.

⁷ Në kuadër edhe të përafrimit të këtij Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore me Planin e Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore – EU GAP III.

II. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e Planit Komunal për Barazi Gjinore 2025-2027 është gjithëpërfshirëse dhe përfshin këto faza kryesore:

- Mbledhja e të dhënave, selektimin, shqyrtimin si dhe analizën e problemeve;
- Hartimin e planit të veprimit me aktivitete dhe veprime të bazuara sipas metodës SMART;
- Konsultimet me: arsimin, shëndetësinë, shoqërinë civile, shoqata të grave, grupe të interesit, biznese, subjekte politike, klube kulturore dhe publike.

Parimet kryesore në hartimin e PLBGJ-së janë:

- Të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut,
- Barazia gjinore është kontribues i rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm në të gjitha sferat e Komunës,
- Komuna e Junikut është e përkushtuar për të promovuar llogaridhënien përmes pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave në vendimmarrje, politikë dhe qeverisje të mirë.
- Planit Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027 është hartuar në koordinim me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe të gjithë mekanizmat e tjerë.
- Duhet theksuar se konsultimet do të bëhen me qëllim që të gjcturat, propozimet me veprime konkrete të kontribuojnë në arrijen e objektivave të këtij plani.

Mbledhja e të dhënave, shqyrtimi dhe analiza e problemeve:

Për tri shtylla të Planit Komunal për Barazi Gjinore 2025-2027 pas hartimit të draft dokumentit dhe finalizimit të tij.

- Agjencia e Statistikave të Kosovës është përdorur si burim kryesor i të dhënave, ky orientim është përcaktuar për të siguruar disponueshmëri të të dhënave për përcjelljen e indikatorëve të synuar.

Gjetjet nga analiza e gjendjes janë diskutuar në grupe punuese, ku edhe është arritur pajtueshmëri për problemin dhe sfidat që duhet adresuar në kuadër të Planit të Veprimit me projekte, kosto sipas metodës SMART.

III. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut siçurse Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (njohur si CEDAW), Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, apo Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje (e njohur si Konventa e Stambollit), drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin vendor dhe në rast konflikti konsiderohet që këto konventa kanë prioritet ndaj akteve dhe ligjeve të nxjertra nga institucionet publike.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve.

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 – 2027 i Komunës së Junikut mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishëm ligjore dhe institucionale, të cilat udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Kosovë. Si më kryesoret mund të përmendim:

1. Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut,
- Konventa për të Drejtat Politike të Grave,
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore,
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve,
- Deklarata dhe Platforma për Veprimin e Pekinit,
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje,
- Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë,
- Agjenda e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm, 2030,
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025,
- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

2. Korniza ligjore dhe zhvillimore kombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7, 21 dhe 22,
- Ligji për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020,

- Ligji për Trashëgimi Nr.2004/26,
- Ligji Nr. 06/L-077 Për ndryshim- plotësimin e Ligjit Nr. 2004/32 Për Familjen,
- Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi Nr.05/L-021,
- Ligji për Pronat dhe të Drejtat Pronësore Nr.03/L-154,
- Ligji i Punës Nr. 03/L-212,
- Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore Nr. 08/L-185,
- Ligji Nr.04/L-81 Për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-17,
- Ligji Nr.2011/04-L-096 Për ndryshim- plotësimin e Ligjit të Skemës së Ndhimave Sociale Nr.2003/15,
- Ligji Nr. 03/L022 Për Mbështetje Materiale të Familjeve me Fëmijë me Afërsi të kufizuar Përhershme,
- Ligji Nr. 08/L-109 Për Kompensimin e Viktimave të Krimit,
- Ligji Nr. 06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijës,
- Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim,
- Programi i Reformave Ekonomike,
- Strategjia për Rregullim më të Mirë,
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave,
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit,
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat Pronësore,
- Rregullorja për banim social,
- Udhëzimi Administrativ 04/2020 për Shëndetësi,
- Plani i veprimit për sëmundjet kronike jo ngjitëse 2021-3-2025, i Ministrisë së Shëndetësisë,
- Plani i Veprimit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor 2024-2026, i Ministrisë së Shëndetësisë, etj.

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PLVBGJ 2025 – 2027 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët e caktuar sipas fushave të tyre.

Përgjegjëse kryesore për zbatimin e PLVBGJ mbetet **Komuna**. Kjo nënkupton përgjegjësi si për zbatim të drejtpërdrejtë të masave dhe veprimeve të parashikuara, ashtu edhe për koordinimin me institucionet dhe akterët përkatës, që bëjnë të mundur zbatimin e këtyre masave dhe veprimeve. Pra nëse komuna nuk ka mundësi financiare, njerëzore apo infrastrukturore që të zbatojë drejtpërdrejt një masë apo veprim të caktuar, përgjegjësia e saj është të koordinohet dhe të bashkërendojë veprimet me atë institucion që e ka këtë mundësi, duke përfshirë edhe OJQ, institucionet private, organizatat ndërkombëtare, etj. Zyrtarja për

Barazi Gjinore (ZBGJ) do të mbetet përgjegjëse për një sërë masash dhe veprimesh të parashikuara në PLVBGJ, por, tashmë ky është një plan i të gjithë komunës ndaj dhe përgjegjësia kryesore për këtë plan në tërësi jo domosdoshmërisht bie mbi ZBGJ. Gjithashtu, PLVBGJ 2025 – 2027, i zbërthyer vit pas viti, zëvendëson edhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore që ZBGJ përgatiste dhe paraqiste përpara Kryetarit të Komunës dhe Agjencisë për Barazi Gjinore, në mënyrë të përvitshme.

Në vijim, të gjitha institucionet lokale dhe OJQ të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PLVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PLVBGJ.

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore, është:

- Një mjet praktik i lokalizimit të dokumenteve të rëndësishme kombëtare, por edhe ndërkombëtare në lidhje me barazinë gjinore (veçanërisht instrumentet drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit).
- Një dokument i hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, me hapa të mirë përcaktuar, e në përmbajtje të të cilit reflektohen arritjet dhe sfidat e hasura ndër vite nga Komuna në përparimin drejt barazisë gjinore.
- Një pasqyrim i qartë i roleve dhe përgjegjësi të domosdoshme për t'u përmbushur brenda Komunës, si dhe ndërmjet Komunës e institucioneve lokale apo organizatave të shoqërisë civile e ato ndërkombëtare, me qëllim zbatimin në praktikë të parimit të barazisë për të gjitha/gjithë gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre në Komunën e Junikut.

IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Vizioni i PLVBGJ-së adreson:

“Një qeverisje të mirë, gjithëpërfshirëse e të drejtë gjinore, ku gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Junikut, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të migrantës/migrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.

Parimet⁸ që udhëheqin zbatimin e PLVBGJ, mbështeten kryesisht në parimet që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, siç paraqiten në vijim:

1. **Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore.** Kjo e drejtë duhet të zbatohet nga organet e vetëqeverisjes lokale në të gjitha fushat e tyre të përgjegjësisë; ajo përfshin gjithashtu edhe detyrimin për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit, të drejtpërdrejt apo të tërthortë.
2. **Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.** Përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore duhet të marrin parasysh dhe të trajtojnë – nga një këndvështrim gjithëpërfshirës, sistemik dhe strukturor – mënyrat se si ndërvepron gjinia me faktorë të tjerë si seksi, raca, ngjyra e lëkurës, origjina etnike ose sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionet politike dhe çfarëdo opinionesh të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, origjina në lindje, aftësitë e kufizuara, moshja, ose orientimi seksual.
3. **Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike.** E drejta për barazi të grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, kërkon që organet vetëqeverisëse lokale të marrin të gjitha masat e duhura dhe të miratojnë të gjitha strategjitë e përshtatshme për promovimin e përfaqësimit dhe të pjesëmarrjes së balancuar në të gjitha sferat e vendimmarrjes.
4. **Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.** Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të nxisin punën për eliminimin e stereotipeve dhe pengesave që krijojnë pabarazi në statusin dhe gjendjen e grave / të rejave / vajzave dhe që janë burimi i vlerësimit të pabarabartë të roleve të grave dhe burrave, të

⁸ Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: https://www.ccre.org/img/uploads/giecesiointe/filename/charte_egalite_al.pdf

rejave dhe të rinjve nga pikëpamja politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

5. **Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes lokale është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.** Perspektiva gjinore duhet të mbahet parasysh gjatë hartimit të politikave, metodave dhe instrumenteve që ndikojnë në jetën e përditshme të popullsisë lokale – për shembull përmes përdorimit të teknikave të “vlerësimeve gjinore”, “auditimit gjinor”, “integrimit gjinor”, dhe të “buxhetimit të përgjegjshëm gjinor”. Për arritjen e këtij synimi duhet të analizohen dhe të merren parasysh përvojat e shumta dhe të gjera të grupeve të ndryshme të grave në jetën lokale, si edhe kushtet e jetesës dhe të punës së tyre.

Planet e veprimit të mbështetura me burimet e duhura janë instrumente të nevojshme për dërgimin përpara të barazisë gjinore. Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të hartojnë plane dhe programe veprimi për barazinë gjinore, të mbështetura me burimet financiare e njerëzore të nevojshme për zbatimin e tyre.

Objektivat strategjikë të PLVBGJ.

PLVBGJ 2025 – 2027 përbëhet nga pesë objektiva strategjike, të cilat janë harmonizuar edhe me:

- Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore,
- Programin e Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024,
- Planin e Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën të Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025,
- Konventën për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
- Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit),
- Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (BDPfA),
- Agjendën 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030,
- Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III),
- Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj

Pesë objektivat strategjike të PLVBGJ 2025- 2027 të Komunës së Junikut, renditen në vijim:

1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
2. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave.
3. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të reja, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.
4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.
5. Adresimi i sfidave dhe promovimi i mundësive për pjesëmarrje të barabartë në veprimet që synojnë zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

Secila nga këto objektiva strategjike është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në

matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PLVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera lokale, organizatat e shoqërisë civile, institucionet private, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparencja e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PLVBGJ.

Tabela 1. Rezultatet e pritshme, objektivat specifike dhe treguesit

Objektivi strategjik: 1. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre. Rezultatet e pritshme: 1.a. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, e përmirësuar. 1.b. Planet e zhvillimit dhe ndërhyrjes në të gjitha fushat, si dhe programet buxhetore të Komunës, me perspektivën gjinore të integruar. Objektivat specifike: 1.1. Krijimi i mundësive të barabarta dhe rritja e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, duke luftuar stereotipet gjinore, diskriminimin dhe disavantazhimin e shumëllojshëm. 1.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Treguesit në nivel objektiv: 1.1.a. Numri i grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, të informuara mbi të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike. 1.2.a. Përqindja e buxhetit komunal dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore.	Objektivi strategjik: 2. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave. Rezultatet e pritshme: 2.a. Pjesëmarrja e grave dhe të rejave në aplikimin dhe përfitim të subvencioneve të komunës në lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin rural, e përmirësuar ndjeshëm. 2.b. Numri i të rejave dhe grave në punësim dhe ndërmarrësi, i rritur si rrjedhojë e veprimeve mbështetëse dhe inkurajuese të komunës. Objektivat specifike: 2.1. Rritja e qasjes së të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime, burime dhe produkte financiare, duke synuar fuqizimin ekonomik, veçanërisht në zonat rurale.
--	--

2.2. Rritja e vetëdijesimit dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet e kujdesit, duke mundësuar ndarje të barabartë të punës shtëpiake dhe të kujdesit midis grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve.

Treguesit në nivel objektiv:

2.1.a. Përqindja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, që mbështeten me subvencione në fushën e bujqësisë

2.2.a. Numri i banoreve / banorëve të informuar për ndarje të barabartë të punës shtëpiake dhe të kujdesit midis grave/ të rejave / vajzave dhe burrave / të rinjve / djemve.

Objektivi strategjik:

3. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.

Rezultatet e pritshme:

3.a. Qasja e grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, e përmirësuar ndjeshëm.

3.b. Më shumë vajza, të reja dhe gra të Komunës, të angazhuara në aktivitete sportive e kulturore.

Objektivat specifike:

3.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejtat dhe djemtë, të rinjtë e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre.

3.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport.

Treguesit në nivel objektiv:

3.1.a. Numri i vajzave, të rejave nga të gjitha grupet, të informuara mbi çështjet e barazisë gjinore

3.2.a. Numri i grave, të rejave dhe vajzave në art, kulturë e sporte, si dhe i klubeve sportive të tyre, që mbështeten me subvencione në mënyrë të përvitshme.

Objektivi strategjik:

4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

Rezultatet e pritshme:

4.a. Edukimi mbi shëndetin seksual e riprodhues mes profesionistëve/profesionistëve dhe në komunitet, merr rëndësi të veçantë.

4.b. Vendimarrja tek vajzat, djemtë, të rejtat, të rinjtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual e riprodhues, e përmirësuar ndjeshëm.

Objektivi specifik:

4.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.

Tregues në nivel objektiv:

4.1.a. Numri i grave, të rejave, vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, me akses të shtuar në kujdesin dhe shërbimet shëndetësore seksuale dhe riprodhuese.

Objektivi strategjik:

5. Adresimi i sfidave dhe promovimi i mundësive për pjesëmarrje të barabartë në veprimet që synojnë zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

Rezultatet e pritshme:

5.a. Edukimit të grave, të rejave e vajzave mbi rëndësinë e njohjes së rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe mënyrës së përballimit të sfidave në situata të tilla, i jepet vëmendje.

5.b. Dokumentet që përgatit komuna për përballimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, kanë të integruar perspektivën gjinore.

Objektivi specifik:

5.1. Nxitja e planifikimit të përgjegjshëm gjinor për përballimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

Tregues në nivel objektiv:

5.1.a. Numri i grave, të reja e vajzave të pajisura me informacion për njohjen e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore.

V. ANALIZA E PËRGJITHSHME GJINORE NË KOMUNËN E JUNIKUT

Sipas Ligjit të ri për Barazi Gjinore 05/L-020 dhe Qarkorës Buxhetore 2025/01 për vitin 2025 të lëshuara nga Ministria e Financave, Komuna e Junikut prezanton këtë përmbledhje të informacioneve kyçe lidhur me Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor.

Kjo analizë fokusohet në paharazitë gjinore si të gjetura pas një analize të thellë gjinore të shpenzimeve për kategori të ndryshme buxhetore të analizës, objektivave, aktiviteteve dhe indikatorëve që duhet të arrihen deri në vitin 2025/2027.⁹

5.1 Informata Demografike për Komunën e Junikut

Administrata komunale nëpunës shërbimit civil janë 186 ku sipas strukturës gjinore 99 janë meshkuj dhe 87 janë femra, sa i përket strukturës etnike 186 janë shqiptar.

Në Kuvendin Komunal janë gjithsej 15 përfaqësues të katër subjekteve politike: LDK-së (6 përfaqësues nga të cilët 4 janë meshkuj dhe 2 janë femra), AAK-së (6 përfaqësues nga të cilët 3 janë meshkuj dhe 3 janë femra), LVV-së (3 përfaqësues nga të cilët 2 janë meshkuj dhe 1 femër), sipas strukturës etnike të gjithë anëtarët e asamblesë komunale janë shqiptar, duke përfshirë gratë dhe meshkujt.

Arsimi- Nëpunës të shërbimit publik 67, sipas strukturës gjinore 25 janë meshkuj dhe 42 janë femra.

Shëndetësia- Nëpunës të shërbimit publik 33, sipas strukturës gjinore 14 janë meshkuj dhe 19 janë femra.

⁹ Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027 (vendimi dhe buxhetimi gjinor i Komunës së Junikut)

5.2 Bazuar në të gjetura, Komuna e Junikut duhet të ndërmerren këto veprime:

- Të hartoj raportin analitik të buxhetimit të përgjithshëm gjinor për vitin 2025 dhe planifikimin për vitin 2026.
- Të gjitha drejtoritë ta bëjnë integrimin e Buxhetit të Përgjithshëm Gjinor në dokumentin buxhetor.
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa të luaj një rolë kyç në institucionalizimin e BPGJ në komunë
- Mungesa e integritetit gjinor në strategji dhe politikat zhvillimore.
- Mungesa e raportimit dhe analizës buxhetore e detajuar për barazi gjinore nga zyra e kryetarit, asamblesë komunale dhe drejtoritë,
- Mungesa e raportimit të statistikave nga perspektiva gjinore në përputhje me kërkesat për barazi gjinore mbetet sfida jo vetëm për nivelin qendror po edhe atë lokal
- Mungesa e gjatë e një plani për barazi gjinore ku ka ndikuar negativisht për t'i adresuar pabarazitë dhe parashihet mbështetje buxhetore.
- Buxheti i përgjithshëm gjinor ende nuk është plotësisht i implementuar përkundër përmirësimeve siç është përmendja e rregullt në qarkoren buxhetore.
- Përkundër përmirësimeve, gratë në masë të madhe ende zotërojnë shumë pak pasuri ku regjistrimi i pasurisë për dy bashkëshortë gjegjësisht të përbashkët është në shkallë jo të kënaqshme.

Tabela 2. Plani i Veprimi për Barazinë Gjinore 2025/2027

Shtylla I-rë	Aktiviteti	Aktei vendimmarrës/përgje gjës për zbatim	Buxhet i			Burimi financiar	Produkti/Pje sëmarrës ne trajnim
	Projekti		2025	2026	2027		
	Ofrimi i trajnimeve profesionale për gratë, me fokus të veçantë për gratë me nivelin e ulët të shkollimit dhe atyre që kanë qenë të papuna për një kohë të gjatë.	Zyra për barazi gjinore OJQ-të ABGJ	200	200	200	Komuna/donator	50
	Punëtori rreth analizës së buxhetimit gjinor, planifikimit dhe nevojave.	Zyra për barazi gjinore OJQ-të dhe ABGJ	200	200	200	Komuna/donator	30
	Punëtori informuese për promovimin e të drejtës për pushimin e lehonisë dhe prindëror	Zyra për barazi gjinore OJQ-te	200	200	200	Komuna/donator	50
	Trajnimi i përfutësve të kategorive sociale dhe angazhimi i tyre në programet e punësimit	Zyra për barazi gjinore OJQ-të ABGJ	200	200	200	Komuna/donator	70
	Ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara	Zyra për barazi gjinore OJQ-të	200	200	200	Komuna/donator	50
	Nxiti e zhvillimit të bizneseve ekzistuese në pronësi të grave nëpërmjet programeve ndihmuese	Zyra për barazi gjinore Drejtoria për Zhvillim Ekonomik OJQ-të ABGJ	300	300	300	Komuna/donator	50
	Aktivitetet sensibilizuese për nxitjen e angazhimit të grave dhe burrave në sektorë deficitar (bujqësi, energjetikë, pylltari, ujëra, mjedis)	Zyra për barazi gjinore Drejtoria për Zhvillim Ekonomik OJQ-të ABGJ	300	300	300	Komuna/donator	70
	Ngrija e kapaciteteve për integrimin gjinor në politika publike, në nivelin qendror dhe lokal	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	300	300	300	Komuna/donator	70
	Punëtori rreth politikave ekzistuese publike (i ligjeve, udhëzimeve administrative, rregulloreve për barazi gjinore	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	300	300	300	Komuna/donator	30
	Ngrija e kapaciteteve për zbatimin e BPGJ	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	100	100	100	Komuna/donator	30
	Fushata për vetëdijësimin e shoqërisë lidhur me rolin e	Zyra për barazi gjinore OJQ-te	100	100	100	Komuna/donator	50

përfshirjes së grave në vendimmarrje në menaxhimin e burimeve natyrore	ABGJ					
Organizimi i panairëve të ndërmarrjeve në pronësi të grave në vend dhe jashtë, për të marrë mësim, rrjetëzim dhe promovim dhe zgjerim të tregut.	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	500	500	500	Komuna/donator	50
Përfshirja e perspektivës gjinore në panairët ekzistues (veror dhe vjeshtor)	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	100	100	100	Komuna/donator	50
Sensibilizimi i grave për mundësitë e përlitimit nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	100	100	100	Komuna/donator	30
Sensibilizimi për pjesëmarrjen e grave fermerë në Shërbime Këshilluese	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	200	200	200	Komuna/donator	30
Informimi i grave për mundësitë dhe përparësitë e organizimit në shoqata dhe këshillimore (takime, broshura)	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	100	100	100	Komuna/donator	50
Ofrimi i trajnimeve në fushën e ndërmarrjes dhe shkëmbimi i përvojave të mira	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	300	300	300	Komuna/donator	70
Ofrimi i mbështetjes (konsulenca, ndihmë juridike falas, rrjetëzimi, etj.)	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	300	300	300	Komuna/donator	70
Mbështetja financiare për shoqatat aktive dhe të reja	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	300	300	300	Komuna/donator	50
Ofrimi i programeve mbështetëse për ndërmarrësi, për gra, të përcjella me këshillime biznesore	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	300	300	300	Komuna/donator	30
Fushata vetëdijësuese për respektimin e kuotës të punësimit për personat me aftësi të kufizuar dhe evitimin e stigmatizimit në shoqëri	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	150	150	150	Komuna/donator	50
Organizimi i fushatave vetëdijësuese për të drejtën në trashëgimi dhe pronë	Zyra për barazi gjinore OJQ-te ABGJ	150	150	150	Komuna/donator	50

Tabela 3. Plani i monitorimit të zbatimit të Planit Komunal për Barazi Gjinore 2025/2027

Nr.	Fusha e veprimit Fuqizimi ekonomik	Aktivitetet	Indikatorët e Suksesit	Ndikimi i prrshëm
1.	Objektivi Krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e mirëqenies sociale.	- Aktivitete provuese për të drejtat në punë dhe pushimi i lehonisë (fushatat vetëdijësuese dhe kampanja informuese për publikun e gjerë me theks të veçantë gratë të cilat janë të gatshme për punë këtu mund të hyjnë edhe trajnimet dhe sesionet informuese) - Ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtat e tyre në qasjen në shërbime. - Krijimi i mundësive për gratë për avancim profesional dhe karrierë në institucionet publike - Analizimi i buxhetit me perspektivë gjinore - Organizmi i takimeve ndërgjegjësuese për të drejtën në trashëgimi dhe pronë - Organizimi i takimeve me gra dhe vajza për informimin dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në dëgjimet buxhetore. - Hartimi analitik i buxhetit përgjithshëm gjinore për secilën drejtori. - Ndërmarrja e masave afirmative për sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë gjinore në përputhje me kërkesat e ligjit për barazi gjinore në pozitat vendimmarrëse. - Mhajtja e aktiviteteve për barazi gjinore dhe kundër dhunës në familje nga anëtarët e Kuvendit komunal. - Organizmi i debatoeve publike që mbështetje	- Njohja me të drejtat për punë dhe pushimi të lehonisë. - Njohja me të drejtat për punë dhe pushimi të lehonisë - Njohja me mundësitë për avancim profesional dhe karrierë për gratë. - Njohja me perspektivën gjinore - Njohja për të drejtën në trashëgimi dhe pronë. - Njohja me shërbimet mbështetëse dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në dëgjimet buxhetore. - Njohja dhe ndërtimi i kapaciteteve. - Njohja me të drejtat për barazi gjinore dhe kundër dhunës në familje nga anëtarët e Kuvendit komunal.	- Ndërtimi i kapaciteteve - Njohja me drejtat e tyre në qasjen në shërbime - Ngritja e kapaciteteve për avancim profesional dhe karrierë - Ndërtimi i kapaciteteve - Ndërtimi i kapaciteteve - Ndërtimi i kapaciteteve dhe financim - Ndërtimi i kapaciteteve në përputhje me kërkesat e ligjit për barazi gjinore në pozitat vendimmarrëse - Ngritja e kapaciteteve për barazi gjinore dhe kundër dhunës në familje nga anëtarët e Kuvendit komunal.

6. PLANI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT

Për monitorimin dhe zbatimin e këtij plani obligohet Zyra e Kryetarit, përkatësisht Zyra për Barazi Gjinore, e cila ka për detyrë të informoj në mënyrë të rregullt për arritjen e objektivave dhe realizimin e aktiviteteve të parapara në Planin Komunal për Barazi Gjinore 2025-2027, i cili do të jetë për periudhën tre vjeçare (plan i punës), ku të paktën një herë në vit Zyra për Barazi Gjinore raporton në Kuvendin e Komunës mbi realizimin e këtij plani.

Raportimet mbi aktivitetet do të jenë Periodike (çdo 6 muaj) ose në bazë të kërkesës së Zyrës së Kryetarit.

Monitorimi i zbatimit të Planit Lokal të Veprimit në nivel të objektivave do të kryhet nga Zyra për Barazi Gjinore. Raportet e përgatitura do të përcillen edhe tek Grupi i Grave të Kuvendit Komunal dhe sipas nevojës/kërkesës edhe në Agjencinë për Barazi Gjinore. Bazuar në monitorimin e kryer, PLVBGJ duhet të rishikohet dhe përmirësohet në mënyrë periodike dhe të paktën çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

01/Nr. Prot: 2-155/1940
 Nje. Org: 2
 Nr. i fac: 2
 Data: 20/03/2025



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK



DATE/A:	13.03.2025
PËR/ZA/TO:	Shpejtim Gacaferi– Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 13, neni 58 dhe Statutit të Komunës së Junikut me Nr. 001/3127 të datës 29.09.2010 neni 43 dhe Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal kërkojmë që të bëhet bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 në vitin 2025.

Në vitin 2024 janë planifikuar të inkasohen të hyra vetanake në vlerë prej 208,056.00€, ndërsa shuma e inkasuar për vitin 2024 duke përfshirë edhe të hyrat nga gjrobat ne trafik është 167,617.13€. Të hyrat e bartura nga viti 2023 në vitin 2024 janë në vlerë prej 147,963.74€, ku gjithsej të hyra në vitin 2024 duke i përfshirë edhe të hyrat e bartura janë 315,580.87€. Nga kjo shumë e të hyrave vetanake gjatë vitit 2024 janë shpenzuar gjithsej 207,096.01€.

Shuma e mbetur për bartje është 108,484.86 € ku kërkojmë që bartja të bëhet në këto Programe dhe kategori ekonomike si vijon:

Kategoria e investimeve kapitale 93,094.50€

- Shuma prej 84,803.40 € të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 46030 “**Bashkëfinancimi i projekteve**”, në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020.
- Shuma prej 5,359.55 € të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 55002 “**Ndërtimi i rrethojës dhe Rekonstruimi i oborrit të stacionit të autobusëve – Faza e Parë**”, në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020 – Projekt i mbetur obligim nga viti 2024.
- Shuma prej 2,321.55 € të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 55014 “**Rikonstruimi i Oborrit të QKMF-së**”, në Programin Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale me kod 730, në nën Programin Shërbimet e shëndetësisë primare me kod 74200 – Projekt i mbetur obligim nga viti 2024.
- Shuma prej 610.00 € të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 54996 “**Rregullimi i infrastrukturës së oborrit të SHFMU E. Hoxha**”, në Programin Arsimit dhe Shkenca me kod 920, në nën programin Arsimit fillor, i mesëm i ulet me kod 93570 – Projekt i mbetur obligim nga viti 2024.

Kategoria e mallrave dhe shërbimeve 10,390.36€

- Shuma prej 10,390.36 € të bartet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Programin Planifikim Urban dhe Mjedis me kod 660, në nën Programin Planifikimi Urban dhe inspeksioni me kod 66405.

Kategoria e Shpenzimeve komunale 5,000.00€

- Shuma prej 5,000.00 € të bartet në kategorinë ekonomike Shpenzime Komunale, në Programin Shërbime publike me kod 180, në nën programin Infrastruktura rrugore me kod 18020.

Në total të hyra për bartje nga viti 2024 në vitin 2025 janë 108,484.86 €